

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shërbimi sekret britanik - MI5 pranon se dha prova të bazuara në gënjeshtër në rastin e spiunazhit neonazist
ADRESA	https://www.syri.net/bote/917598/mi5-pranon-se-dha-prova-te-bazuara-ne-genjeshter-ne-rastin-e-spiunazhit-neonazist/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:55:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 12:49:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0c2d38bc247ab33faf4521cce60726dacba500b20330092618d311c8a111cf0e
TEKSTI	6e88c315c74921f0ca070d0f13c359c94d7552ea5661ba0999b8d2d2960b9a5a
PAMJA	5eaeda71b3a64129d1e5ddd97b906938459489d23d063b214072feb5a862677d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d2104395770ff6aa47e88a7df43918065bfa4a10f5850198e6d1cb5c316c5057
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c2d3424a52af1d7a5bda261c525771941165d93d82c499297c4e9de151b879e4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d2104395770ff6aa47e88a7df43918065bfa4a10f5850198e6d1cb5c316c5057>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



MI5 pranon se dha prova të bazuara në gënjeshtër në rastin e spiunazhit neonazist

14:49, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Shërbimi britanik i sigurisë, MI5, ka pranuar se u ka paraqitur tri gjykatave prova të bazuara në gënjeshtër dhe se oficerë të lartë të tij kanë qenë vazhdimisht të pandershëm.

Është hera e parë që MI5 pranon se gjykatave u janë thënë gënjeshtër, ndërsa shërbimi mbronte një spiun të dhunshëm neonazist, abuzimi i të cilit u zbulua nga BBC.

Gënjeshtërat u zbuluan nga BBC në shkurt të vitit 2025, por më pas shërbimi i sigurisë i mohoi me forcë.

Timothy Otty KC, i cili përfaqëson MI5, e bëri këtë pranim gjatë një seance dëgjimore në Gjykatën e Lartë në Londër të premtën.

Ai tha se "MI5 i pranon pa rezerva" përfundimet e një raporti kritik, i cili arriti në përfundimin se shërbimi kishte dhënë prova të bazuara në "gënjeshtër" lidhur me respektimin e politikës së tij kryesore të sekretit, e njohur si "as konfirmo, as moho" (NCND), në lidhje me statusin e agjentit të informatorit neonazist.

Shërbimi i sigurisë pretendoi se kishte respektuar politikën NCND dhe, për këtë arsye, gjykatat e lejuan të mbante sekret informacionin nga një grua që ishte abuzuar prej tij.

Por ajo që tha MI5 ishte e pavërtetë.

Në fakt, shërbimi i sigurisë ia kishte zbuluar statusin e agjentit të këtij burri gazetarit të BBC-së gjatë telefonatave që i kishte bërë, ndërsa përpjeqje ta bindte të mos e hetonte atë në vitin 2020.

Një trupë prej tre gjyqtarësh të lartë, përfshirë gjyqtaren më të lartë të Anglisë dhe Uellsit, kryetaren e Gjykatës së Lartë, Baroneshën Sue Carr, presidenten e Divizionit të Gjykatës së Lartë, Dame Victoria Sharp, dhe gjyqtarin Chamberlain, po shqyrton se çfarë masash duhet të ndërmerren lidhur me provat e reme.

Në veçanti, ata do të vendosin nëse do të nisin procedura për shpërfillje të gjykatës ndaj disa oficerëve të MI5 apo edhe vetë MI5. Çdo veprim i tillë do të ishte i paprecedentë.

më të lexuarat

Pakistani dënon përpjekjen 'e neveritshme' për sulm me dron pranë Mekës

Forcat izraelite tërhiqen nga qyteti perëndimor i Sirisë pas një ofensive disa orëshe

Ushtria izraelite nis sulme të reja në Libanin jugor pavarësisht marrëveshjes kornizë

Konferenca e IAEA-s/ Irani note proteste Austrisë pasi shefit bërthamor iu mohua hyrja në Vjenë

Filipine/ 6 nxënës të vrarë dhe 17 të tjerë të plagosur nga të shtënat në një shkollë të mesme

Sanksionet e SHBA ndaj Rusisë/ Kina kundër: Marrëdhëniet dypalëshe s'duhet të prishen



Raporti, i hartuar nga ish-zëvendëskomisioneri i atëhershëm i Kompetencave Hetimore, Sir John Goldring, zbuloi se një oficer i lartë i MI5, i njohur si Oficeri 2, kishte gënjer vazhdimisht, ndërsa një tjetër, Oficeri 3, kishte mashtruar kolegët e tij dhe kishte gënjer për atë që ishte thënë.

Raporti zbuloi gjithashtu se kishte pasur "dështime serioze dhe sistematike në sjelljen e MI5" gjatë gjithë çështjes.

Otty tha se MI5 "e pranon plotësisht dhe e njeh seriozitetin e çështjeve të ngritura" në raportin e publikuar në korrik dhe se këto gjëra nuk duhet të ndodhin më kurrë.

Ai shtoi se MI5 ishte angazhuar për një program të gjerë reformash nën drejtimin e drejtorit të përgjithshëm, Sir Ken McCallum.

Otty argumentoi kundër nisjes së procedurave për shpërfillje të gjykatës, duke thënë se kjo nuk do të ishte në interesin publik, duke pasur parasysh hetimin e detajuar të Sir John, kërkimfaljen e MI5 dhe angazhimin e tij për një program reformash.

Ai tha se Oficeri 2 kishte dhënë dorëheqjen nga shërbimi, ndërsa Oficeri 3 ishte pezulluar dhe po përballje me procedura disiplinore, të cilat mund të çonin në shkarkimin e tij.

Avokatët e të dy oficerëve argumentuan gjithashtu kundër nisjes së procedurave për shpërfillje të gjykatës.

Matthew Butt KC, që përfaqëson Oficerin 2, tha se oficeri pranoi që sjellja e tij kishte rënë "nën standardin e pritur prej tij", për të cilën kishte kërkuar falje dhe kishte shprehur keqardhje.

Por ai mohoi të kishte vepruar në mënyrë të pandershme ose të kishte ndërhyrë në administrimin e drejtësisë dhe nuk i pranoi përfundimet e raportit.

Aaron Watkins kërkoi falje në emër të Oficerit 3 dhe pranoi se sjellja e tij "padyshim" kishte kontribuar në mashtrimin e gjykatave dhe palëve të përfshira, por mohoi se kjo kishte qenë rezultat i pandershmërisë.

Ai tha se provat e paraqitura nga Sir John nuk e përmbushnin prapën për shpërfillje të gjykatës dhe se një procedurë e tillë nuk do të ishte në interesin publik, pasi tashmë ishte kryer një hetim i plotë.

Ndërkohë, avokatët e BBC-së thanë se, sipas tyre, pragu ishte përmbushur dhe se kishte një "interes shumë të qartë publik" për nisjen e procedurave.

Jude Bunting KC tha se dhënia e provave të rreme ishte "një fyerje veçanërisht serioze ndaj administrimit të drejtësisë" dhe vuri në dukje se, ndërsa MI5 tani i kishte kërkuar gjykatës një falje të sinqertë, reagimi i tij kur gënjeshtroi u zbuluan për herë të parë "nuk ishte në përputhje me transparencën apo përgjegjshmërinë".

Rasti përqendrohet te një neonazist mizogjin, një informator i MI5 i njohur si Agjenti X, i cili e përdori rolin e tij në shërbimin e sigurisë si një mjet abuzimi.

Ai ushtronte kontroll me forcë ndaj partneres së tij, të njohur me pseudonimin Beth, dhe e sulmoi atë me një hanxhar. Më pas, MI5 e ndihmoi të largohej nga vendi për të vazhduar punën e inteligjencës, ndërkohë që ai ishte nën hetim nga policia.

Qeveria e çoi BBC-në në gjyq në vitin 2022, në një përpjekje të pasuksesshme për të bllokuar hetimin e saj ndaj X-it, por i siguroi atij anonimitet ligjor.

Më pas, Beth paditi MI5 në Tribunalin e Kompetencave Hetimore dhe në vitin 2024 kërkoi rishikimin e një vendimi në Gjykatën e Lartë.

Duke argumentuar për ruajtjen e sekretit në të tria gjykatat, shërbimi i sigurisë u tha gjyqtarëve se gjithmonë i ishte përmbajtur politikës së tij kryesore të sekretit dhe se nuk i kishte thënë kurrë askujt nëse X ishte agent, përfshirë edhe

Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme gjatë natës, dëme në të dyja palët

BE i hap derën Kanadasë për t'u bërë 'anëtarja e parë e asociuar' e bllokut

Trump kërcënon BE me ndërprerje të tregtisë nëse Kanadaja bëhet anëtare e asociuar

gazetarin e BBC-së.

Gjykatave iu paraqit kjo deklaratë në një dëshmi të betuar nga një oficer i lartë, një zëvendës drejtor i identifikuar si Dëshmitari A.

Gjykata i pranoi argumentet e MI5.

Kjo do të thoshte se Beth dhe të gjithë të tjerët u penguan të informoheshin zyrtarisht se X ishte agjent dhe iu mohua qasja në prova kyçe.

Ajo u vu në një disavantazh serioz dhe mund ta kishte humbur çështjen.

Oficeri 2 ishte përpjekur ta mbronte këtë burrë, duke thënë në mënyrë të rreme se ai nuk ishte një mizogjin abuziv dhe as një ekstremist i vërtetë.

Pas vendimit të gjykatës në fund të vitit 2024, BBC e sfidoi MI5 dhe tha se shërbimi kishte gënjyer gjykatat.

MI5 e mbajti me forcë qëndrimin se politika e saj NCND ishte zbatuar, derisa BBC paraqiti prova që tregonin se kjo ishte e pavërtetë, përfshirë një regjistrim të një prej telefonatave me Oficerin 2.

Pas zbulimeve të BBC-së, u zhvilluan dy hetime zyrtare, të cilat e përjashtuan MI5 dhe oficerët e tij nga keqbërja e qëllimshme, duke pretenduar se provat e rreme kishin ardhur si pasojë e gabimeve dhe kujtesës së dobët.

Por, në korrik 2025, një trupë gjyqtarësh të lartë të Gjykatës së Lartë vendosi se hetimet e kryera nga MI5 kishin "mangësi serioze procedurale" dhe se "ne nuk mund të mbështetemi në përfundimet e tyre".

Hetimi i Sir John u urdhërua nga kryeministri në shtator 2025, pasi shpjegimet e MI5 lidhur me atë që kishte ndodhur u refuzuan si të mangëta dhe të pabesueshme.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Alarmi për dronë pezullon zgjedhjet parlamentare në Soçi të Rusisë



Burnham zotohet të 'thellojë marrëdhëniet' me BE-në



'Viktima më e re, një 4-vjeçare' - OKB dokumenton dhunën seksuale dhe torturat e forcave ruse në Ukrainë

TË NGJASHME



Austria prezanton ligjin e ri - Qeveria synon neutralitetin klimatik deri më 2040



Të paktën 15 të vdekur e 50 të plagosur nga shpërthimi i një makine-bombë në Pakistan



Të paktën 14 të vrarë në një sulm me makinë-bombë në Pakistan



Tensione gjatë zhvendosjes së emigrantëve në Ceuta



Kandidatja e BE-së, Moldavia, në kërkim të kohës së humbur



Lëvizja strategjike për të shmangur dënimin me vdekje e Khalid Shaikh Mohammed-it



Samiti SHBA-Kinë/ Kryeministrja japoneze pritet të takohet me Trump të martën

LAJME POLITIKE KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që iu mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.